

VENDIM
Nr. 14, datë 21.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.3.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 21 (A) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ahmet Nezha

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Kredive,
Shoqëria Përmbartimore "AFA 2010"

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1080 (185), datë 12.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Kredive (ATK), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjekti tjetër i interesuar, shoqëria përmbartimore "AFA 2010", si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ahmet Nezha në datën 31.3.1993 ka lidhur marrëveshje me Bankën Bujqësore Dega Lushnjë (*kredi bankare*) për marrjen e kredisë në vlerën 2,000,000 lekë, me interes 39%, me afat kthimi 9 muaj. Në datën 25.3.1993 kërkuesi ka nënshkruar para noterit deklaratën për vënien si garanci për kredinë bankare të një shtëpie banimi njëkatëshe, të ndodhur në fshatin Çiflik, Lushnjë. Pas lidhjes së kontratës ai ka paguar vetëm një pjesë të detyrimit të kredisë në shumën 300,000 lekë.

2. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të drejtat e bankave tregtare të nivelit të dytë i kaluan ATK-së. Me kërkesë të kësaj të fundit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Lushnjë, me vendimin nr. 305, datë 8.7.2003, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për aktin e kredisë bankare të kërkuarit. Në vijim, në datën 5.4.2004, ATK-ja i është drejtuar Zyrës së

Përmbartimit Shtetëror Lushnjë për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Zyra përmbartimore, me vendimin nr. 172 prot., datë 18.11.2005, ka vendosur pushimin e ekzekutimit, me arsyetimin se nuk rezultonin pasuri në emër të kërkuarit. E njëjta kërkesë është bërë nga ATK-ja edhe në vitin 2009, sipas së cilës detyrimi i kërkuarit ishte 8,138,271 lekë, por sërish zyra përmbartimore, me vendimin nr. 140 prot., datë 12.4.2011, ka vendosur pushimin e ekzekutimit, me arsyetimin se kreditori, ATK-ja, kishte paraqitur kërkesë me shkrim pranë asaj zyre për heqje dorë nga urdhri i ekzekutimit.

3. Rreth një muaj pas këtij vendimi, ATK-ja, në datën 23.5.2011, ka vënë në lëvizje shoqërinë private përmbartimore “AFA 2010”, e cila ka filluar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm. Shoqëria përmbartimore, me vendimin e datës 21.6.2011, ka vendosur masën e sekuestros për mjetin në pronësi të kërkuarit; me urdhrin e datës 29.6.2011 ka vendosur masën e sekuestros ekzekutive në llogarinë bankare të kërkuarit në shumën 50,008 lekë dhe bllokimin e të gjitha llogarive deri në shlyerjen e detyrimit në masën 8,528,907 lekë; me vendimin e datës 20.7.2011 ka vendosur masën e sekuestros mbi shtëpinë e banimit të tij. Për këtë fundit, shoqëria përmbartimore ka zhvilluar edhe procedurat e ankandit.

4. Në datën 16.7.2012 kërkuari, me pretendimin se detyrimi ishte shuar, ka ngritur padi në gjykatë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv “Akt i kredisë bankare”, si dhe pezullimin e procedurave të ekzekutimit. Ndërkohë, sipas vërtetimit të lëshuar nga ATK-ja në datën 30.11.2012, detyrimi i mbetur për t’u shlyer nga kërkuari ishte 8,142,263 lekë, i përbërë nga principi në vlerën 1,700,000 lekë, interesi deri në urdhrin e ekzekutimit në vlerën 6,438,171 lekë; shpenzime gjyqi në vlerën 54,100 lekë dhe zbritja e arkëtimit në vlerën 50,008 lekë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 1235 (2751), datë 31.12.2012, ka vendosur pranimin e padisë, duke arsyetuar se detyrimi ishte shuar. Sipas saj, ATK-ja kishte vepruar për herë të parë në datën 5.4.2004, jashtë afatit 10-vjeçar të parashkrimit shues të parashikuar nga neni 114 i Kodit Civil (KC), që kishte përfunduar në datën 31.12.2003.

6. ATK-ja ka paraqitur ankim kundër vendimit. Gjykata e Apelit Vlorë ia ka përcjellë çështjen për kompetencë lëndore Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 991, datë 13.5.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, me arsyetimin se e drejta për të kërkuar ekzekutimin e detyrimit ishte parashkruar.

7. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs ATK-ja dhe avokati i shtetit pranë Ministrisë së Financave. Sipas ATK-së, detyrimi nuk është parashkruar, pasi: i. ATK-së i ka lindur e drejta e kërkit të detyrimit pas krijimit të saj si agjenci, në vitin 1998 dhe në vitin 2002 ka marrë atributet e bankave të nivelit të dytë; ii. debitori ka arkëtuar shumën 300,000 lekë në datën 27.6.1994; iii. urdhri i ekzekutimit është lëshuar në vitin 2003 dhe në vijim janë kryer veprimet për vjeljen e detyrimit. Edhe sipas rekursit të avokatit të shtetit pranë Ministrisë së Financave detyrimi nuk është parashkruar, pasi: i. ATK-së i ka lindur e drejta për kërkimin e detyrimit pas krijimit të saj si agjenci dhe marrjes në dorëzim të dosjes që i përkiste debitorit; ii. urdhri i ekzekutimit është lëshuar në datën 8.7.2003, pa u plotësuar afati 10-vjeçar; iii. kërkuari në datën 14.7.2011 ka arkëtuar shumën 50,000 lekë, që do të thotë se ai e njeh detyrimin.

8. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1080 (185), datë 12.5.2022, ka vendosur, në dhomë këshillimi, ndryshimin e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykatat më të ulëta dhe rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se qëndrimet e tyre kanë qenë në linjë të gabuar, pasi nuk përputhen me parashikimet e ligjit material dhe procedural. Sipas Gjykatës së Lartë, afati 10-vjeçar i parashkrimit të padisë është ndërprerë në datën 27.6.1994, kur debitori ka përmbushur një pjesë të detyrimit, ndaj në këtë datë ka filluar sërish afati i parashkrimit. Në kushtet kur ATK-ja ka kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm në datën 5.4.2004, atëherë pretendimi i kërkuarit se është tejkaluar afati 10-vjeçar i parashkrimit sipas neneve 112 e 114 të KC-së bie.

9. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), të regjistruar në datën 12.9.2022, me objekt shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 6.12.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

10.1 *E drejta për akses* në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për kohën e shqyrtimit të rekursit të tij dhe përbërjen e trupit gjykues që do të shqyrtonte rekursin. Pavarësisht se është interesuar vazhdimisht, ai është vënë në dijeni pas dhënies së vendimit, në datën 2.8.2022, se njoftimi ishte shpallur vetëm në ambientet e gjykatës. Për këtë shkak atij i janë cenuar edhe parimet e kontradiktoritetit dhe gjykatës së paanshme, si dhe e drejta e mbrojtjes dhe gjykimit të drejtë.

10.2 *Standardi i arsyetimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe aludon për vënien në vonesë të debitorit sipas përcaktimeve të KC-së, kur një fakt i tillë nuk rezulton nga aktet e dosjes, ndërsa në rekurs nuk janë paraqitur shkaqe ligjore për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit.

10.3 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë e ka interpretuar ligjin duke mos respektuar praktikën e konsoliduar të saj lidhur me parashkrimin shues të titujve ekzekutivë për çështje të së njëjtës natyrë. Sipas kësaj praktike, afati i parashkrimit fillon nga momenti që kreditorit i lind e drejta për të kërkuar detyrimin, kurse në detyrimet kontraktore me afat, siç është kredia bankare, afati i parashkrimit fillon ditën që përfundon afati i kredisë.

11. **Subjekti i interesuar**, ATK-ja, duke parashtruar veprimet e kryera prej saj ka prapësuar se procesi gjyqësor ka qenë i rregullt.

12. **Subjekti i interesuar**, shoqëria përmbarimore “AFA 2010”, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit të subjekteve që mund t’i drejtohen Gjykatës është një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe, për rrjedhojë, ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve ligjore efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të inicuar prej tij për deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv “Akt i kredisë bankare” për shkak të shuarjes së detyrimit me parashkrim. Për pasojë, Gjykata vlerëson se kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion është përmbushur, pasi kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi.

17. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 12.5.2022, kurse ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 31.8.2022. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Për sa i përket kriterit të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Në këtë pikëpamje, pretendimet e kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për akses në kuptimin substancial i parë së bashku me të drejtën e ankimit, të parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe, si të tilla, Gjykata do të analizojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për akses substancial

19. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e njoftimit për orën, datën dhe trupin gjykues që do të shqyrtonte rekursin, pasi nuk ka marrë dijeni për to, pavarësisht interesimit të vazhdueshëm të tij në sistemin elektronik të Gjykatës së Lartë dhe ambientet fizike të saj. Kancelaria e asaj gjykate me shkresën nr. 3460/1, datë 2.8.2022, pas përfundimit të procesit, e ka informuar se shpallja e njoftimit nuk ishte realizuar në sistemin elektronik, por vetëm në ambientet e gjykatës, por pa përcaktuar nëse njoftimi ishte vendosur në vendin e aksesueshëm për qytetarët. Për këto arsye, kërkuesi pretendon se i është shkelur parimi i mbrojtjes dhe kontradiktoritetit, si dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Po kështu, në parashtrimet drejtuar seancës plenare, ai ka evidentuar se nuk ka marrë dijeni rregullisht as për rekursin e ushtruar nga avokati i shtetit pranë Ministrisë së Financave.

20. Subjekti i interesuar, ATK-ja, nuk ka prapësuar me argumente konkrete lidhur me këtë pretendim të kërkuesit por është shprehur se i gjithë procesi i ndjekur ka qenë i rregullt dhe në përputhje me aktet ligjore.

21. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

22. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për

mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse akses i në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata ka evidentuar rëndësinë e të drejtës për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, e cila u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Gjithashtu, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se kërkesat kushtetuese të procesit të rregullt ligjor janë reflektuar në përmbajtje të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), sipas të cilit shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi (*pika 1*). Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara (*pika 2*). Në shtesë të këtyre rregullave, neni 482, pika 3 i Kodit të Procedurës Civile (KPC), i zbatueshëm për gjykimin administrativ, parashikon se njoftimi me shpallje bëhet edhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Krahas njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Këto rregulla janë detajuar në urdhrin nr. 131, datë 2.7.2021, "Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve" të nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.

24. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, rekursi i paraqitura nga ATK-ja dhe avokati i shtetit, i janë njoftuar rregullisht atij nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Kështu, rekursi i ATK-së i është njoftuar personalisht kërkuetit në datën 6.7.2015 nëpërmjet ftuesit të gjykatës në adresën e banimit, ndërsa rekursi i avokatit të shtetit i është njoftuar me shpallje publike pranë Bashkisë Divjakë, në periudhën 1.9.2015 - 22.9.2015. Është e vërtetë që njoftimi individual i këtij rekursi fillimisht është kthyer me shënimin "adresë e pamjaftueshme" nga shërbimi postar, por ky fakt nuk ka cenuar thelbin e të drejtës së njoftimit, për sa kohë gjykata ka proceduar në vijim me njoftimin nëpërmjet shpalljes, e cila ka qëndruar e afishuar për një periudhë të arsyeshme kohore prej 21 ditësh.

25. Më tej, çështja e kërkuetit është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 31003-02146-00-2015, datë 12.10.2015 dhe për të është caktuar trupi gjykues, bazuar në vendimin nr. 8, datë 25.3.2022, të Këshillit të Gjykatës së Lartë, "Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues të secilit kolegji" (*vendimi nr. 8/2022*). Me vendimin e datës 27.4.2022, relatori i çështjes ka caktuar datën 12.5.2022 për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, si dhe ka urdhëruar sekretarinë të kryejë njoftimin e palëve për orën dhe ditën e caktuar.

26. Në datën 12.5.2022 Gjykata e Lartë ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe, në përfundim, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, si dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se qëndrimet e tyre kanë qenë në linjë të gabuar, pasi nuk përputhen me parashikimet e ligjit material dhe procedural.

27. Mbi bazën e kërkesës së kërkuarit, Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 3460/1 prot. datë 2.8.2022, e ka informuar atë se nga verifikimet në sekretarinë gjyqësore rezultonte se lista e shpalljes është realizuar vetëm pranë ambienteve të gjykatës, për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Ndërkohë, nga verifikimet e kryera në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura në gjykim”, ku pasqyrohen të dhënat e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit, përfshirë datën e shpalljes, numrin e çështjes, palët ndërgjyqëse, bazën ligjore, trupin gjykues, relatorin, datën dhe orën e shqyrtimit, ashtu edhe në rubrikën “Çështje të ardhura”, ku pasqyrohen detajet e çështjes, nuk rezulton e publikuar ndonjë e dhënë apo informacion lidhur me datën dhe orën e seancës, ose datën e planifikimit.

28. Në këtë kontekst faktesh, Gjykata vëren se mungesa e njoftimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë lidhur me datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes së kërkuarit, përbën mangësi në mënyrën e njoftimit të palëve, asaj me shpallje, edhe pse njoftimi është realizuar në ambientet fizike të gjykatës. Për sa i përket alternativës tjetër të njoftimit, atij individual, një gjë e tillë nuk duket të ketë qenë e zbatueshme në rastin e kërkuarit, ndërsa nga ai nuk pretendohet të ketë lënë të dhënat e tij elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyqimit. Në lidhje me mangësinë procedurale të konstatuar në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në drejtim të njoftimit me shpallje të palëve, Gjykata vlerëson se një mangësi e tillë duhet analizuar në aspektin e ndikimit të saj në të drejtën kushtetuese të aksesit substancial, të lidhur me të drejtat e tjera procedurale kushtetuese për kërkuarin. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se jo çdo shkelje procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e respektimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuarin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimin nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimin nr. 7, datë 28.2.2000, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke iu referuar këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se mungesa e njoftimit me shpallje në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë nuk rezulton ta ketë vendosur kërkuarin në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e aksesit në aspektin substancial. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Gjykata mban në konsideratë faktin se, nga njëra anë, kërkuari ishte njoftuar rregullisht për rekursin e paraqitura nga palët ndërgjyqëse. Po kështu, njoftimi për datën dhe orën e shqyrtimit të procesit të tij ishte afishuar nga Gjykata e Lartë në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj (*shih supra paragrafin 27*). Nga ana tjetër, pretendimi i tij se mungesa e njoftimit e ka penguar të paraqiste parashtrime deri 5 ditë para zhvillimit të seancës, është formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa treguar ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë, i cili potencialisht mund të passillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Për më tepër, Gjykata konstaton se kërkuari, ndonëse është njoftuar rregullisht për rekursin, ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs, për mbrojtjen eventuale të çështjes së tij. Gjykata mban në konsideratë po ashtu se në rekursin e paraqitura janë ngritur të njëjtat pretendime që nuk janë marrë parasysh më parë nga gjykatat më të ulëta, ndërkohë që në rrjedhën e procesit gjyqësor kërkuari ka pasur mundësinë dhe ka arritur të realizojë mbrojtjen e interesave të veta, ndërsa pretendimet e tij janë gjetur të drejta dhe konsideruar të plota për pranimin e padisë nga ato gjykata. Gjithashtu, Gjykata evidenton se vendimi i Këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 8/2022, që përcaktonte përbërjen e kolegjeve të saj, gjendet i publikuar në faqen elektronike në rubrikën “Gjykata - Organizimi juridik - Këshilli i Gjykatës - Vendime”. Në rastin e tij, çështja është shqyrtuar nga trupi gjykues nr. 1 i

Kolegjit Administrativ dhe përbërja e këtij kolegjii është publike dhe e aksesueshme, si nga palët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar. Ndërkohë, nuk rezulton që kërkuesi të ketë argumentuar në mënyrë konkrete pasjen e pretendimeve në drejtim të ndonjë prej anëtarëve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar çështjen e tij. Për rrjedhojë, mangësia e konstatuar për sa i përket njoftimit të palëve me shpallje në faqen elektronike, në kontekst të rastit konkret, nuk mund të klasifikohet si shkelje thelbësore që e bën të parregullt në kuptimin kushtetues procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

30. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit në aspektin substancial është i pabazuar¹.

B.2. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit

31. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë, nëpërmjet një arsytimi kontradiktor, ka aluduar për vënien në vonesë të debitorit sipas përcaktimeve të KC-së, kur një fakt i tillë nuk rezulton nga aktet e dosjes.

32. Subjekti i interesuar, ATK-ja, nuk ka prapësuar me argumente konkrete lidhur me këtë pretendim të kërkuetit, por është shprehur se i gjithë procesit i ndjekur ka qenë i rregullt dhe në përputhje me aktet ligjore.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, pasi ka pasqyruar në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur rrethanat e çështjes dhe shkaqet e rekursit të paraqitur nga ATK-ja, ka vijuar me vlerësimin e çështjes në raport me dispozitat ligjore të zbatueshme, materiale dhe procedurale të përcaktuara në legjislacionin material dhe procedural civil lidhur me institutin e parashkrimit të padisë, si dhe në legjislacionin e kohës që normonte krijimin dhe funksionimin e ATK-së. Po kështu, vendimi paraqitet logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, duke përmbushur standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është i pabazuar.

B.3. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

35. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar ligjin dhe ka anashkaluar praktikën e konsoliduar të saj lidhur me parashkrimin shues të titujve ekzekutivë, duke mbajtur qëndrime të ndryshme për çështje të së njëjtës natyrë. Sipas kësaj praktike, fillimi i afatit të parashkrimit është taksativ që nga momenti që kreditorit i ka lindur e drejta për të kërkuar detyrimin, dhe në detyrimet kontraktore me afat, parashkrimi nis nga përmbushja e afatit.

36. Subjekti i interesuar, ATK-ja, ka prapësuar se ajo nuk i ka shkaktuar asnjë dëm kërkuetit. Ky i fundit ka nënshkruar kredinë në datën 31.3.1993, me afat maturimi datën 31.12.1993, ka arkëtuar shumën 300,000 lekë sipas mandatit të arkëtimit në datën 27.6.1994, gjashtë muaj pas maturimit të kredisë dhe i është aprovuar ristrukturimi i kredisë deri në datën 31.3.1998. Kërkuetit do t'i lindte e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nëse në dosjen e tij nuk do të kishte të dhëna që të vërtetonin veprimet dhe njoftimet e kryer nga kreditori për shlyerjen e detyrimit. Kërkuesi nuk duhet të mohojë faktin që është kontaktuar disa herë nga punonjësit e bankës dhe ATK-ja ndër vite, dhe që përveç shumës 300,000 lekë ka shlyer edhe shumën 50,000 lekë në datën 14.7.2011.

¹ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e këtij pretendimi, për shkak të vendbanimit jashtë Tiranës dhe mungesës së një avokati të kërkuetit.

37. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, i cili nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 50, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe, për rrjedhojë, parimi i sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjithashtu, Gjykata evidenton se interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë, e cila ka autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t’u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr. 47, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, e ka argumentuar cenimin e parimit të sigurisë juridike nga Gjykata e Lartë, duke e lidhur me mënyrën e interpretimit të dispozitave të KC-së për llogaritjen dhe ndërprerjen e afatit 10-vjeçar të parashkrimit të detyrimit “kredi bankare”, në procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm në mënyrë të ndryshme prej saj. Në mbështetje të këtij pretendimi, ai ka referuar vendimet nr. 156, datë 17.4.2014 dhe nr. 657, datë 9.12.2015, me të cilat dy kolegjet e Gjykatës së Lartë – civil dhe administrativ, kanë analizuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për shkak të parashkrimit të së drejtës për të kërkuar ekzekutimin, sipas nenit 609 të KPC-së.

40. Gjykata, në analizë të argumenteve, evidenton se kërkuesi nuk ndodhet në kushtet e ndonjë të drejte të fituar nga ligji apo nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, e cila të jetë vënë në dyshim nga vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë. Çështja e parashkrimit të detyrimit, të cilën ai e ngre si shkak kryesor përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe para kësaj Gjykate, lidhet me interpretimin dhe zbatimin e normave ligjore në një rast konkret, çka është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, e cila ka kompetencën të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore. Për më tepër, dy vendimet e referuara nga kërkuesi në mbështetje të këtij pretendimi, lidhen me parashkrimin e detyrimeve të ndryshme nga ato të kredisë bankare. Konkretisht, vendimi i vitit 2014 lidhet me parashkrimin e detyrimit nga shpërblimi i dëmit jashtëkontraktor, bazuar në nenin 115, shkronja “dh”, të KC-së, ndërsa vendimi i vitit 2015 lidhet me detyrimet e krijuara nga shoqëritë jobankare huamarrëse, bazuar në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”. Në këto dy raste, Gjykata e Lartë, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, nuk ka pasur për objekt interpretimin dhe zbatimin e ligjit në lidhje me ndërprerjen e afatit të parashkrimit të detyrimit të lindur nga një “Akt i kredisë bankare”.

41. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara dhe kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.3.2023.

Shpallur më 20.4.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Ahmet Nezha, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1080 (185), datë 12.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, ne, gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marsida Xhaferllari, jemi kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se ajo duhej të ishte pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrijmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes, rezulton se padia e ngritur nga kërkuari për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv “Akt i kredisë bankare”, për shkak të shuarjes së detyrimit, është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Rekursi i ushtruar nga ATK-ja dhe avokati i shtetit pranë Ministrisë së Financave është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 12.10.2015. Me vendimin e datës 27.4.2022 relatori i çështjes ka caktuar datën 12.5.2022 për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, por pa përcaktuar orarin e zhvillimit të saj, si dhe ka urdhëruar sekretarinë e gjykatës të kryejë njoftimin e palëve për orën dhe ditën e caktuar. Njoftimi për datën, orën dhe trupin gjykues është shpallur i afishuar vetëm në ambientet fizike të asaj gjykate, ndërkohë që nuk është shpallur në faqen elektronike të saj. Në procesverbalin e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, që mban datën 12.5.2022, ora 15:10, është shënuar se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit nëpërmjet shpalljes së datës 26.4.2022 dhe nuk rezulton të kenë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përjashtimin e trupit gjykues, ndërsa kërkuari nuk rezulton të ketë paraqitur kundërrekurs ose parashtrime me shkrim ndaj pretendimeve në rekurs të palës tjetër, ATK-së. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues është tërhequr për marrjen e vendimit dhe ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, si dhe rrëzimin e padisë.

3. Shumica ka vlerësuar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit, në aspektin substancial, është i pabazuar. Sipas saj, mangësia e konstatuar për sa i përket njoftimit të palëve me shpallje në faqen elektronike, në kontekst të rastit konkret, nuk mund të klasifikohet si shkelje thelbësore që e bën të parregullt në kuptimin kushtetues procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë; ajo nuk rezulton ta ketë vendosur kërkuarin në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e aksesit, në aspektin substancial, pasi njoftimi ishte afishuar nga Gjykata e Lartë në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, kërkuari, ndonëse është njoftuar rregullisht për rekursin, ka

zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs për mbrojtjen eventuale të çështjes së tij, ai nuk ka treguar ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë, i cili potencialisht mund të passillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes nga Gjykata e Lartë, në rekurset e paraqitura janë ngritur të njëjtat pretendime që nuk janë marrë parasysh më parë nga gjykatat më të ulëta, ndërkohë që në rrjedhën e procesit gjyqësor kërkuesi ka pasur mundësinë dhe ka arritur të realizojë mbrojtjen e interesave të veta, ndërsa pretendimet e tij janë gjetur të drejta dhe konsideruar të plota për pranimin e padisë nga ato gjykata (*shih paragrafin 29 të vendimit*).

4. Në ndryshim nga shumica, çmojmë se pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit, në aspektin substancial, për shkak të parregullsive të njoftimit, për datën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, është i bazuar. Në nxjerrjen e këtij përfundimi vlejné të evidentohen tri arsye kryesore.

5. *Së pari*, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga njëra anë, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata ka një jurisprudencë të konsoliduar për mbrojtjen e garancive të procesit të rregullt në drejtim të njoftimit dhe pjesëmarrjes në proces të palëve ndërgjyqëse, duke verifikuar për këtë qëllim rregullsinë e procedurave të njoftimit të ndjekura nga Gjykata e Lartë. Në një numër të konsiderueshëm rastesh të ankimeve kushtetuese individuale që kanë pasur në objektin e tyre këtë pretendim, Gjykata, pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në seancë publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka verifikuar nga pikëpamja faktike nëse njoftimi është realizuar në mënyrat e domosdoshme të përcaktuara nga ligji – me anë të shpalljes në ambientet fizike dhe shpalljes në faqen elektronike. Kur është konstatuar se njoftimi për datën e zhvillimit të seancës në Gjykatën e Lartë nuk ka qenë i shpallur në faqen elektronike të saj, Gjykata e ka pranuar pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke argumentuar se sekretaria e Gjykatës së Lartë ka detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve, me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes, barazisë së armëve në gjykim dhe kontradiktoritetit (*shih vendimet nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 17, datë 1.3.2017; nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 76, datë 16.12.2016; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky konstatim ka qenë i mjaftueshëm për Gjykatën për të pranuar kërkesën dhe për të kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Madje, Gjykata ka pohuar se njoftimi i datës dhe orës së gjykimit është një akt i domosdoshëm procedural, që merr rëndësi më tepër në rastin kur Gjykata e Lartë ka ndryshuar dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë e kërkuetit. Në këtë rast, moskomunikimi i zhvillimit të seancës nga ana e administratës gjyqësore, në përputhje me rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit administrativ, sjell mospërfitimin e garancive ligjore të kërkuetit për njohjen në kohë të pretendimeve të palës tjetër dhe kundërshtimin e tyre nëpërmjet paraqitjes së argumenteve, kjo me qëllim shmangien e vënies në një pozitë të pafavorshme në raport me atë palë (*shih vendimin nr. 65, datë 7.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Mbi bazën e kësaj jurisprudence, nuk pajtohem me argumentin e shumicës, që ka shërbyer për rrëzimin e pretendimit për cenimin e së drejtës së njoftimit, sipas të cilit, ndonëse kërkuesi është njoftuar rregullisht për rekurset, ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs dhe se në rrjedhën e procesit gjyqësor ai ka pasur mundësinë dhe ka arritur të realizojë mbrojtjen e interesave të veta. Në këtë pikë duhet evidentuar se vendimmarrja e gjykatave të të dyja shkallëve të para të gjykimit ka

vendosur në favor të kërkuarit, ndërsa vendimarrja e Gjykatës së Lartë e ka përmbysur këtë rezultat, duke e rrëzuar padinë e ngritur prej tij në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vitin 2012.

8. *Së dyti*, rëndësia e njoftimit të palëve për zhvillimin e gjykimit, përfshirë atë të Gjykatës së Lartë, dhe forcimi i garancive për realizimin e njoftimit efektiv janë përkrahur edhe nga zhvillimet e fundit legjislativë, si dhe nga praktika e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ato u janë përgjigjur zhvillimeve të teknologjisë së informacionit, që kanë lehtësuar komunikimin në jetën e përditshme, pavarësisht distancave gjeografike. Kështu, fillimisht, në vitin 2012, ligji për organizimin e gjykatave administrative dhe, më tej, ndryshimet në KPC, në vitin 2017, kanë parashikuar përdorimin e mjeteve elektronike gjatë procesit, ku krahas njoftimit me shpallje në ambientet fizike realizohet edhe njoftimi në faqen elektronike të gjykatës, si edhe njoftimi individual i drejtpërdrejtë në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë, me urdhrin e datës 2.7.2021, ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore që, përveç afishimit në këndin e njoftimit dhe shpalljes në faqen elektronike, të kryejë edhe njoftimin elektronik në adresat e postës elektronike të palëve.

9. Në këtë kontekst, ne ndajmë vlerësim të ndryshëm me shumicën, sipas së cilës mungesa e njoftimit në faqen elektronike nuk përbën shkelje thelbësore, pasi çmojmë se ky argument dobeson garancitë e individit dhe nuk i përgjigjet zhvillimit aktual shoqëror. Në këtë drejtim, sjellim në vëmendje se evoluimi i mënyrave të veprimit, edhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike, paraqet rëndësi për të lehtësuar dhe siguruar jo vetëm efektivitetin e këtyre veprimeve, por edhe përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve. Përdorimi i këtyre mjeteve është i nevojshëm në procedurat gjyqësore, pasi, pavarësisht distancave fizike të selive të gjykatave dhe vendbanimeve të palëve ndërgjyqëse, krijon mundësi komunikimi dhe aksesit në kohë reale dhe të garantuar.

10. *Së treti*, nisur nga rrethanat e çështjes konkrete, vlerësojmë se kriteri i përdorur nga shumica, sipas të cilit kërkuari ngarkohet me barrën për të paraqitur një *“argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë, i cili potencialisht mund të passillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së tij”*, së bashku me faktin se rekursi është marrë në shqyrtim pas më shumë se 6 vjetësh e gjysmë nga regjistrimi i tij, nga njëra anë, krijon një barrë joproporcionale për individin, që ia vështirëson gjer në mohim të drejtën e aksesit në gjykim. Ndërsa, nga ana tjetër, krijon konflikt juridiksioni, pasi e vendos Gjykatën në pozicionin për të vlerësuar bazueshmërinë e themelit të shkaqeve të rekursit, që është pjesë e juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

11. Nën këtë analizë, vlerësojmë se Gjykata e Lartë duke e realizuar njoftimin vetëm me shpallje në ambientet fizike, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftimin edhe në faqen elektronike të saj. Mënyra se si Gjykata e Lartë ka vepruar, në dukje të krijon idenë sikur ka vendosur dhe përmbysur rezultatin e çështjes në disfavor të kërkuarit, vetëm mbi bazën e pretendimeve të parashtruara në rekurs nga pala tjetër, duke mos i dhënë mundësinë atij të dëgjohej dhe të mbrohej me shkrim në lidhje me çështjen. Për më tepër, barra e vendosur ndaj kërkuarit është dukshëm joproporcionale, pasi shqyrtimi i rekursit është bërë pas një kohe relativisht të gjatë, banonte në një fshat të Lushnjës dhe pritshmëritë që ai të paraqitej vijimisht gjatë 6 vjetëve e gjysmë në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë janë haptazi të paarsyeshme. Në këto kushte, Gjykata e Lartë ka dështuar në garantimin e procesit të rregullt gjyqësor, pasi e ka vendosur kërkuarin në pamundësi për të paraqitur pretendimet e tij, i cili jo vetëm potencialisht, por edhe faktikisht është prekur nga vendimarrja e saj, duke u vendosur në pozita të pafavorshme.

12. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në aspektin substancial, është i bazuar, për rrjedhojë ankimi kushtetues i tij duhej të pranohej pjesërisht dhe të vendosej shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Fiona Papajorgji